



BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT & NISMA "REFORMA REALE"

NGA: **Bashkimi Liberal Demokrat dhe Nisma Reforma Reale.**

OBJEKTI: Dërgojmë propozimet për projektligjin me disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", si dhe bashkëngjitur, relacionin shpjegues lidhur me propozimet e paraqitura nga **Bashkimi Liberal Demokrat** dhe **Nisma Reforma Reale**.

DREJTUAR: Anëtarëve nismëtarë të Forumit Dialogut Politik:

- z. Ermal Hasimja, politolog dhe administrator në fushën e arsimit.
- z. Redi Ramaj, pedagog, avokat dhe ekspert i së drejtës.
- z. Hektor Ruci, pedagog dhe ekspert i së drejtës kushtetuese.

Të nderuar Zotërinj,

Me anë të kësaj shkrese, na lejoni t'ju përgëzojmë për iniciativën tuaj në ndërtimin e urës së komunikimit ndërmjet subjekteve politike të krahut opozitar në Republikën e Shqipërisë.

Ajo që duhet theksuar është se ndodhemi në një moment ku, përtej ndarjeve ideologjike, duhet të bashkohemi për të forcuar demokracinë funksionale në jetën tonë politike.

Bashkimi Liberal Demokrat në bashkëpunim me **Nisma Reforma Reale**, pas konsultimeve të zhvilluara me anëtarët e subjektit politik Bashkimi Liberal Demokrat dhe grupet e interesit që janë



pjesë e Nismës Reforma Reale, kanë dalë me propozime konkrete, të cilat i kemi materializuar në formën e një projektligji.

Ky projektligj nuk ka vetëm si qëllim normimin e këtyre propozimeve, por mbi të gjitha synon pranimin nga të gjithë faktorët politikë që ndryshimet zgjedhore të vijnë si rezultat i një dakordësie politike, ku asnjë subjekt garues të mos ketë përparësi ndaj tjetrit. Të gjitha subjektet që marrin pjesë në zgjedhje duhet t'u nënshtrohen rregullave të garës politike në mënyrë të barabartë.

Parimi themelor është që sistemi zgjedhor në Republikën e Shqipërisë të bazohet mbi zgjedhje të lira dhe të barabarta, në përputhje me standardet demokratike dhe legjislacionin në fuqi. Ky parim duhet të shërbejë si bazë udhëheqëse për çdo ndryshim të mundshëm që miratohet në Parlament.

Propozimet tona synojnë që të mos preket Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe që çdo ndryshim në Kodin Zgjedhor aktual të mos normohet pa një konsultim të gjerë ndërmjet faktorëve politikë dhe shoqërisë civile.

Ftojme të gjitha palët që gara zgjedhore të jetë e hapur dhe të mos kufizohet përmes imponimit të modeleve që favorizojnë një grup të caktuar. Roli ynë është të hapim garën dhe, në këtë përballje demokratike, të punojmë për të bindur qytetarët shqiptarë, njëkohësisht duke vazhduar mbrojtjen e demokracisë në vend.

Nëpërmjet Jush, dëshirojmë që këto dy akte shkresore projektligji dhe relacioni shpjegues, të bashkëngjitura kësaj shkrese t'u përcillen të gjitha partive politike dhe grupeve të ndryshme të interesit, të cilat dëshirojnë të bashkëveprojnë për një dialog më të gjerë në tryezat e ardhshme, me qëllim diskutimin e mënyrave për forcimin e demokracisë përmes një gare të lirë dhe të barabartë.

NËNSHKRUAJNË

BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

KRYETARI

Dr. ARIAN STAROVA

NISMA "REFORMA REALE"

KRYETARI

Av. GYLSEN ZHLLIMA

Tiranë, më 18.05.2026.





BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT & NISMA "REFORMA REALE"

RELACION SHPJEGUES

Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë"

I. Qëllimi i projektligjit

Ky projektligj synon reformimin dhe modernizimin e një sërë dispozitash të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, me qëllim forcimin e standardeve demokratike, garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të barabarta, rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor, si dhe përmirësimin e administrimit të zgjedhjeve nëpërmjet profesionalizimit të administratës zgjedhore dhe përdorimit të teknologjisë mbështetëse.

Projektligji ndërhyr në disa aspekte themelore të procesit zgjedhor, duke përfshirë përkufizimet bazë të Kodit Zgjedhor, organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, mënyrën e numërimit dhe vlerësimit të votave, votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, funksionimin e komisioneve zgjedhore, procedurat për shpërndarjen e mandateve dhe organizimin e zgjedhjeve vendore.

II. Përmbajtja dhe ndryshimet kryesore të projektligjit

1. Përkufizime dhe parime themelore të ligjit zgjedhor

Projektligji riformulon disa nga përkufizimet bazë të nenit 2 të Kodit Zgjedhor, duke përcaktuar më qartë:



Konceptin e “Qendrës së votimit dhe numërimit”, procesin e “Identifikimit elektronik” të zgjedhësit, statusin dhe garantimin e të drejtave të “zgjedhësve me aftësi të kufizuara”.

Gjithashtu, riformulohet neni 4 i Kodit, duke forcuar parimin se sistemi zgjedhor në Republikën e Shqipërisë bazohet mbi zgjedhje të lira dhe të barabarta, në përputhje me standardet demokratike dhe legjislacionin në fuqi.

Projektligji përcakton në mënyrë të shprehur detyrimin e subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore, dhe gjykatave, për respektimin e këtyre parimeve, duke i dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kompetenca më të qarta për ndërhyrje në rast cenimi të tyre.

2. Riorganizimi i administratës zgjedhore

Një nga ndryshimet më të rëndësishme të projektligjit është profesionalizimi i administratës zgjedhore. Projektligji shfuqizon disa dispozita ekzistuese lidhur me nënkomisionerin dhe përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, ndryshon mënyrën e përbërjes së Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV), dhe Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Sipas projektligjit anëtarët e këtyre komisioneve do të propozohen kryesisht nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Dhoma e Noterisë së Shqipërisë, sekretarët e komisioneve duhet të kenë formim juridik, synohet depolitizimi i administrimit zgjedhor dhe garantimi i profesionalizmit dhe paanshmërisë në administrimin e procesit.

Projektligji parashikon gjithashtu detyrimin ligjor të profesioneve të rregulluara për të bashkëpunuar me KQZ-në në plotësimin e vendeve vakante në administratën zgjedhore.

3. Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Projektligji riformulon dispozitat lidhur me regjistrimin dhe administrimin e votuesve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Parashikohet që regjistrimi të kryhet individualisht nëpërmjet një platforme elektronike të administruar nga KQZ-ja, zgjedhësi të paraqesë pasaportën biometrike dhe deklaratë për qëndrimin



jashtë vendit në ditën e zgjedhjeve, zgjedhësit e regjistruar jashtë vendit të çregjistrohen nga listat e zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë vendit do të kryhen nga komisione të posaçme, këto komisione do të përbëhen nga përfaqësues të propozuar nga Dhoma e Avokatisë dhe Dhoma e Noterisë.

4. Organizimi i qendrave të votimit dhe procesi i numërimit

Projektligji sjell ndryshime të rëndësishme në mënyrën e organizimit të qendrave të votimit dhe procesit të numërimit të votave.

Ndryshimet kryesore përfshijnë kufizimin e numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi nga 300 deri në 700 zgjedhës, përqendrimin e qendrave të votimit në godina të mëdha publike, zhvillimin e procesit të numërimit në të njëjtën qendër votimi ku është zhvilluar votimi.

Projektligji parashikon përdorimin e kamerave dhe monitorëve për regjistrimin dhe transmetimin në kohë reale të procesit të numërimit, ruajtjen elektronike të materialeve filmike dhe garantimin e transparencës për subjektet zgjedhore, vëzhguesit dhe median.

Gjithashtu përcaktohen procedura më të detajuara për transportimin, marrjen në dorëzim dhe administrimin e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, parashikohen masa për trajtimin e kutive të parregullta dhe procedurat për pezullimin ose vazhdimin e numërimit në rast mospërputhjesh.

5. Numërimi dhe vlerësimi i votave

Projektligji synon standardizimin dhe rritjen e transparencës së procesit të numërimit të votave. Parashikohen procedura më të qarta për verifikimin e kutive dhe materialeve zgjedhore, mekanizma për rivlerësimin e votave të kontestuara, ndërhyrja e KZAZ-së në rast mosmarrëveshjesh gjatë numërimit, vijimësia e pandërprerë e procesit të numërimit deri në përfundimin e tij. Gjithashtu, ndalohet refuzimi i numërimit të kutive të rregullta, një veprim i tillë konsiderohet shkelje penale sipas Kodit Penal.



6. Listat e kandidatëve dhe mbështetja zgjedhore

Projektligji ndryshon kriteret për regjistrimin e partive politike dhe koalicioneve, mbështetjen me firma të zgjedhësve, përjashtimet nga detyrimi për mbledhjen e firmave mbështetëse.

Parashikohet që partitë ose koalicionet që kanë marrë të paktën 1% të votave të vlefshme në zgjedhjet pararendëse të përjashtohen nga mbledhja e firmave mbështetëse dhe subjektet që nuk e arrijnë këtë prag të detyrohen të mbledhin firma sipas kriterëve të përcaktuara në Kod.

7. Shpërndarja e mandateve dhe sistemi zgjedhor

Projektligji riformulon nenin 162 të Kodit Zgjedhor, duke përcaktuar pragun kombëtar prej 1% për pjesëmarrjen në shpërndarjen e mandateve për Kuvendin, metodën e ndarjes së mandateve nëpërmjet koeficientëve zgjedhorë dhe procedurat për rastet e barazimit të koeficientëve. Kjo dispozitë synon rritjen e proporcionalitetit, shmangien e fragmentarizimit të tepërt politik dhe garantimin e një përfaqësimi më funksional parlamentar.

8. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Projektligji ndryshon mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të bashkive. Parashikohet që kandidati fitues duhet të marrë mbi 50% + 1 të votave të vlefshme, në rast se asnjë kandidat nuk arrin këtë shumicë, organizohet raundi i dytë ndërmjet dy kandidatëve më të votuar dhe raundi i dytë zhvillohet katër javë pas raundit të parë. Ky sistem synon forcimin e legjitimitetit të kryetarëve të bashkive dhe sigurimin e mbështetjes më të gjerë elektorale.

9. Teknologjia në zgjedhje

Projektligji përcakton financimin dhe procedurat për prokurimin e pajisjeve teknologjike, përdorimin e sistemeve të transmetimit të sigurt të rezultateve (SRT), ndalimin e përdorimit të sistemeve të votimit elektronik. Gjithashtu, parashikohet përdorimi i pajisjeve që realizojnë identifikimin në kohë reale të zgjedhësve dhe synohet forcimi i sigurisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.



III. Efektet e pritshme të projektligjit

Miratimi i këtij projektligji pritet të sjellë rritjen e besueshmërisë së procesit zgjedhor, depolitizimin e administratës zgjedhore, përmirësimin e transparencës dhe kontrollit publik mbi procesin e numërimit, forcimin e standardeve demokratike, garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të zgjedhësve, përmirësimin e administrimit të votimit nga jashtë vendit dhe rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë institucionale.

IV. Përfundime

Projektligji përfaqëson një ndërhyrje të gjerë dhe strukturore në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, me synim modernizimin e sistemit zgjedhor dhe forcimin e integritetit të proceseve zgjedhore. Nëpërmjet profesionalizimit të administrimit zgjedhor, përdorimit të teknologjisë mbështetëse, rritjes së transparencës dhe garantimit të standardeve demokratike, projektligji synon të krijojë një proces zgjedhor më të besueshëm, më transparent dhe më të drejtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Propozohet rritja e numrit të bashkive **nga 61 në 101** dhe reduktimi i numrit të qarqeve **nga 12 në 7**.

NËNSHKRUAJNË PROPOZIMET

BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

KRYETARI

Dr. ARIAN STAROVA

NISMA "REFORMA REALE"

KRYETARI

Av. GYLSEN ZHLLIMA

Tiranë, më 18.05.2026.





BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT & NISMA "REFORMA REALE"

PROPOZOJNË SI MË POSHTË:

Projektligjin

**"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008,
"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".**

Neni 1

Përkufizime

Neni 2, pika 16, riformulohet si vijon:

"Qendër votimi dhe numërimi" është mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimit dhe numërimit të votave në qendrën e votimit, në përputhje me këtë Kod.

Neni 2, pika 27, riformulohet si vijon:

"Identifikimi elektronik" është procesi i verifikimit të identitetit të zgjedhësit përmes leximit elektronik të kartës së identitetit dhe përputhjes së të dhënave personale me bazën elektronike të të dhënave të listës së zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe përmes leximit të menjëhershëm të shenjave daktiloskopike në pajisjen përkatëse në qendrën e votimit ku paraqitet zgjedhësi.

Neni 2, pika 29, shfuqizohet.

Neni 2, pika 30, shfuqizohet.

Neni 2, shtohet pika 32 si me poshte vijon:

"Zgjedhësit me aftësi të kufizuara" janë personat që kanë shprehur vullnetin e tyre për të marrë pjesë në procesin zgjedhor në mënyrë të pavarur, dhe për të cilët kërkohet sigurimi i kushteve të përshtatshme dhe masave mbështetëse nga KQZ-ja për ushtrimin e barabartë dhe të plotë të së drejtës së votës.



Neni 2

Ligji zgjedhor në Republikën e Shqipërisë bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta.

Riformulohet titulli i nenit 4 si më poshtë vijon:

Ligji zgjedhor në Republikën e Shqipërisë bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta.

Neni 4, pika 1, riformulohen si më poshtë vijon:

1. Ky ligj garanton respektimin e parimeve demokratike të zgjedhjeve të lira dhe të barabarta, sipas përcaktimeve që jepen në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike përbën një element themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim apo në shkelje të këtyre parimeve.

Neni 4, pika 2, riformulohen si më poshtë vijon:

2. Detyrimi për respektimin e parimeve të zgjedhjeve të lira dhe të barabarta u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë brenda kompetencave që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij ligji, të kërkojë nga subjektet zgjedhore pushimin e cenimit të këtyre parimeve dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tyre.

Neni 4, pika 3, riformulohen si më poshtë vijon:

3. Ligji zgjedhor nxit dhe garanton zgjedhje të lira dhe të barabarta përmes:

- a) garantimit të ushtrimit të lirë të së drejtës së votës dhe pjesëmarrjes së barabartë të zgjedhësve në procesin zgjedhor;
- b) sigurimit të trajtimit të barabartë të të gjitha subjekteve zgjedhore në të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
- c) marrjes së masave për parandalimin e votimit të kontrolluar nga palë të treta, votimit familjar dhe çdo forme tjetër ndikimi në vullnetin e zgjedhësit, si dhe garantimit të fshehtësisë së votës;
- ç) sigurimit të transparencës së procesit zgjedhor dhe publikimit të të dhënave operative mbi pjesëmarrjen në zgjedhje, me qëllim forcimin e besimit publik dhe përmirësimin e procesit zgjedhor.

Neni 3

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Neni 14, shfuqizohet.



Neni 4

Kompetencat e Rregullatorit

Neni 20, pika 1, germa (e), shfuqizohet.

Neni 20, pika 2, germa (c), shfuqizohet.

Neni 5

Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje

Neni 22, shfuqizohet.

Neni 6

Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja

Neni 23, shfuqizohet.

Neni 7

Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Neni 25, pika 5, riformulohet si vijon:

5. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja, aplikon individualisht për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Për regjistrimin në listë, zgjedhësi ngarkon në platformën elektronike pasaportën biometrike, e cila duhet të jetë e vlefshme, si dhe një deklaratë të thjeshtë, të nënshkruar prej tij, ku deklaron se në ditën e zgjedhjeve do të qëndrojë jashtë vendit.

Neni 25, pika 6, riformulohet si vijon:

6. Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në deklaratën e zgjedhësit, në të cilën kërkon që materialet zgjedhore t'i dërgohen në atë adresë.

Neni 25, pika 9, riformulohet si vijon:

9. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij neni, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit, e cila shpallet sipas nenit 56 të këtij Kodi. Me shpalljen e rezultatit përfundimtar për zgjedhjet e Kuvendit, lista e zgjedhësve jashtë vendit ribëhet nga e para për çdo palë zgjedhësh për Kuvendin.



Neni 8

Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rezultati zgjedhor

Neni 25/2, pika 4, riformulohet si vijon:

4. Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë administrohen nga një komision i përbërë prej 4 anëtarësh dhe një sekretar i emëruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Propozimi për 2 anëtarë bëhet nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, ndërsa për 2 anëtarët e tjerë propozimi bëhet nga Dhoma e Noterisë së Shqipërisë. Sekretari i komisionit duhet të jetë jurist me profesion. Anëtarët dhe sekretari duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të këtij Kodi. Nëse numri në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë është më i madh se 80 mijë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të ngrejë më shumë se një komision për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, me kusht që vlerësimi i votave të një qarku të kryhet nga i njëjti komision.

Neni 25/2, pika 5, riformulohet si vijon:

5. Për numërimin dhe vlerësimin e votave Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton grupe numërimi të përbërë nga dy anëtarë. Një anëtar propozohet nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe anëtari tjetër nga Dhoma e Noterisë së Shqipërisë.

Neni 9

Përbërja e KZAZ-së

Neni 29, pika 1, geramat a, b dhe c, riformulohen si vijon:


- a) Tre anëtarë propozohen nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, ndërsa tre anëtarë të tjerë propozohen nga Dhoma e Noterisë së Shqipërisë.
- b) Anëtari i shtatë përzgjidhet me short nga zona zgjedhore perkatese.
- c) Sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.
- ç) Shfuqizohet.

Anëtarët e KZAZ-së, të propozuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Dhoma e Noterisë së Shqipërisë, nuk mund të jenë anëtarë në zonën zgjedhore ku kanë vendbanimin dhe selinë e ushtrimit të profesionit të tyre.

Neni 29, pika 2, riformulohet si vijon:

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së zgjidhen nga KQZ-ja, me propozim të KZAZ-së.

Neni 29, pikat 4,5 shfuqizohen.



Neni 29, pika 8, riformulohet si vijon:

8. Kur vendi i një anëtari ose i sekretarit të KZAZ-së mbetet vakant në ditën e zgjedhjeve, propozimi në KQZ duhet të dorëzohet jo më vonë se 3 orë nga çasti i krijimit të vakancës. Në rast se subjektet me të drejtë propozimi nuk paraqesin kandidaturë në KQZ, kjo e drejtë i kalon KQZ-së, e cila emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.

Neni 10

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

Neni 32, pika 2, germa (d), riformulohet si vijon:

d) subjekti që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

Neni 32, pika 3, riformulohet si vijon:

3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast.

Neni 11

Përbërja e KQV-së

Neni 36, pika 1, riformulohet si vijon:

1.KQV-ja përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhjeje.

Neni 36, pika 3, riformulohet si vijon:

3.Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 37 dhe 38 të këtij Kodi. Në çdo rast emërimi i kryetarit dhe sekretarit bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 12

Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së



Neni 42, pikes 4, shtohet germa (ë) si vijon:

Pasi mbyllet procesi i votimit në qendrën përkatëse, në të njëjtën qendër votimi realizohet njëkohësisht edhe numërimi i votave.

Neni 13

Lista e zgjedhësve

Neni 46, pika 2, riformulohet si vijon:

2. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 700 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj.

Neni 14

Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë

Neni 51, pika 3, riformulohet si vijon:

3. Kur numri i zgjedhësve të një zone qendre votimi është më i madh se 700, lista e zgjedhësve ndahet në aq pjesë të barabarta sa qendra votimi ngrihen për atë zonë qendre votimi, në përputhje me nenin 62. Listat e ndara u caktohen qendrave në përputhje me numrin rendor të zgjedhësve, ku pjesa e parë i përket qendrës së votimit me numrin bazë. Në këtë rast, programi kompjuterik i RKGJC-së bën ndarjen automatike të listës mbi bazën e numrit të qendrës së votimit të caktuar çdo zgjedhësi. Zgjedhësit me të njëjtin mbiemër nuk mund të ndahen në lista të ndryshme.

Neni 15


Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit

Neni 62, pikes 1, riformulohet si vijon:

1. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 300 dhe më i madh se 700 zgjedhës, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 59 të këtij Kodi.

Neni 62, pikes 6, riformulohet si vijon:

6. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 700 zgjedhës dhe lista është ndarë sipas nenit 51 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin qendrës shtesë të votimit brenda së



njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërohet sipas sistemit unik kombëtar të numërtimit të qendrave të votimit.

KQZ-ja, pasi ka marrë mendimin e subjekteve zgjedhore, është e detyruar të bëjë përqendrimin e disa qendrave të votimit në godina të mëdha, të cilat garantojnë jo më pak se 10 dhe jo më shumë se 30 qendra votimi në çdo godinë.

Neni 16

Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike

Neni 67, pikat 6 dhe 10 shfuqizohen.

Neni 17

Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve

Neni 68, pikës 1, riformulohet si vijon:

1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 101 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 301 zgjedhësve në shkallë kombëtare.

Neni 68, pika 2, riformulohet si vijon:


2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më shumë se 1 001 dhe jo më pak se 51 zgjedhës.

Neni 68, pikës 3, riformulohet si vijon:

3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet në çdo kohë një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit ose nga njësi e qeverisjes vendore, ku vërtetohet mbajtja e mandatit përpara përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të mbajtësve të mandateve për përkatësinë në partinë politike ose koalicionin përkatës, pranë institucionit përkatës.

Neni 68, shtohen pikat 4, 5 dhe 6 si vijon:

4. Për efekt të zbatimit të nenit 68, partia politike ose koalicioni përjashtohet nga zbatimi i pikave 1 dhe 2, nëse subjekti zgjedhor paraqet një vërtetim me shkrim, të lëshuar dhe të nënshkruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin vërtetohet se subjekti zgjedhor, veçmas ose së



bashku, ka marrë pjesë si parti politike ose koalicion në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë ose në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe ka siguruar jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi si subjekt zgjedhor. Në rast se një subjekt zgjedhor paraqet një vërtetim të tillë, ai nuk pengohet të kandidojë në zgjedhjet e ardhshme si koalicion ose si parti politike.

5. Partia politike ose koalicioni i cili ka marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë ose në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe ka siguruar më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi, si subjekti zgjedhor në zgjedhje, detyrohet të zbatojë parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

6. Partia politike ose koalicioni, i cili nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë ose në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore detyrohet të zbatojë parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 18

Zona zgjedhore për Kuvendin

Neni 74, pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

2. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: **a) bashki 101 b) qarqe 7**. Kufijtë administrativë të bashkive dhe qarqeve vendosen me ligjin për ndarjen administrative e territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

Vendndodhja e qendrave të votimit dhe selive të KZAZ-ve

Riformulohet titulli i nenit 93 si më poshtë vijon:

Vendndodhja e qendrave të votimit dhe selive të KZAZ-ve

Neni 93, pika 1,2 dhe 4 riformulohen si më poshtë vijon:

1. Qendrat e votimit dhe selitë e KZAZ-ve, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë.

2. Qendrat e votimit dhe selitë e KZAZ-ve nuk mund të krijohen:

4. Me kërkesë të një anëtari të saj, KQZ-ja urdhëron administratën për të kryer verifikimin përkatës në terren, e cila paraqet një raport për plotësimin e kushteve të parashikuara në këtë Kod apo në akte të tjera. Vendimi merret në konsultim me përfaqësuesit e akredituar të subjekteve në KQZ. Një kopje e vendimit të KQZ-së afishohet qartë në hyrjen e qendrave të votimit në ditën e votimit.

Neni 20

Infrastruktura e nevojshme logjistike të qendrave të votimit



Riformulohet titulli i nenit 94 si më poshtë vijon:

Infrastruktura e nevojshme logjistike të qendrave të votimit

Neni 94, riformulohet si më poshtë vijon:

1. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja përgatit infrastrukturën e nevojshme logjistike të qendrave të votimit, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave, sipas planvendosjes tip të miratuar nga KQZ-ja dhe udhëzimeve përkatëse të KQZ-së. Për këtë, KQZ-ja vendos tryeza pune për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave. Tryezat e punës vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme nga anëtarët e KQV-së, subjekteve zgjedhore, vëzhguesit, kandidatët ose përfaqësuesit e medias dhe të mundësojnë aplikimin e teknologjisë mbështetëse, sipas pikës 2 të këtij neni. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit në një largësi të vogël nga tryezat e punës ose, nëse përdoret teknologjia sipas pikës 2 të këtij neni, përballë monitorëve. Vëzhguesit nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit. Skema organizative e funksionimit dhe numri i tavolinave të numërimit për çdo qendër votimi përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

2. KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në medie elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZ-ja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore.

Neni 21


Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)

Neni 95, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:

1. Numërimi i votave pranë çdo QV-je, sipas nenit 36 e vijues të këtij kodi, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para datës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e neneve 30 dhe 31 të këtij Kodi. Propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Neni 95, pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

2. Grupet e numërimit të votave pranë çdo QV-je, sipas nenit 36, përbëhen nga shtatë anëtarë. KQZ-ja, me udhëzim, përcakton mënyrën e hedhjes së shortit publik dhe merr të dhënat e zonës zgjedhore



përkatëse nga lista e zgjedhësve për të bërë përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave pranë çdo QV-je.

Neni 95, pika 3, riformulohet si më poshtë vijon:

3. Në rast se anetari nuk paraqitet brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, KZAZ-ja cakton me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të KQV-ve në rang zone zgjedhore. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se tre anëtarë.

Neni 95, pika 4, riformulohet si më poshtë vijon:

4. Një grup numërimi numëron jo më pak se 3 00 vota dhe jo më shumë se 700 vota. Në përfundim të këtij procesi grupi i numërimit zëvendësohet nga grupi tjetër i numërimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 22

Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve

Neni 96, shfuqizohet.

Neni 23

Veprimet pas mbylljes së votimit

Neni 113, shtohet pika 9 si më poshtë vijon:

9. Anëtarët e grupeve të numërimit pranë çdo qendre votimi marrin në dorëzim nga KQV-të procesverbalin e kutive/kutisë së votimit dhe materialet zgjedhore, dhe fillojnë procedurat duke zbatuar nenet 116 deri në 120 për procedurat e fillimit të numërimit të votave, sipas këtij Kodi dhe akteve të KQZ-së.

Neni 24

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve të votimit pranë KZAZ-ve

Riformulohet titulli i nenit 114 si më poshtë vijon:

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve të votimit pranë KZAZ-ve.

Neni 114, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:



1. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të parashikuara në nenin 113 të këtij Kodi, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe Kutia me Materialet e Votimit dorëzohen pranë KZAZ-ve, të caktuar sipas nenit 94 të këtij Kodi. Materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit i dorëzohen KZAZ-së brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 114, pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

2. Kutia/kutitë e votimit me fletët e votimit dhe Kutia me Materialet e Votimit dorëzohen jo më vonë se 5 orë nga mbyllja e numërimit në qendrën e votimit. Dërgimi i tyre bëhet me automjet, në të cilin ndodhen anëtarët dhe sekretari i KQV-së, së bashku me anëtarët dhe sekretari i GNV-së, si dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe paprekshmërinë e kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të Kutisë së Materialeve të Votimit. KQZ-ja autorizon KZAZ-në, duke i dhënë edhe fondet e nevojshme financiare, për të siguruar transportimin me automjet të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të Kutisë me Materialet e Votimit pranë KZAZ-së. Skema organizative e transportimit të materialeve të votimit me automjet, si dhe e personave që do të shoqërojnë kutinë e votimit nga anëtarët e KQV-së dhe GNV-së përkatëse, përcaktohet me akt normativ të KQZ-së, pasi kjo e fundit të ketë marrë edhe mendimin e subjekteve zgjedhore.

Neni 25

Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja

Neni 115, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:

1. KZAZ-ja cakton për marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë/kutive me materialet e votimit një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Nëse gjykohet e nevojshme, KZAZ-ja mund të caktojë 2 persona për çdo grup në ndihmë të grupit për marrjen në dorëzim të kutive, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Personeli ndihmës zgjidhet nga lista e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave. Kutia/kutitë me fletët e votimit dhe kutia/kutitë me materialet e votimit merren në dorëzim sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

Neni 115, pika 5, riformulohet si më poshtë vijon:

5. Kutitë e votimit të përcaktuara si “KUTI E PARREGULLT” në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja. Ato dërgohen së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ, sipas nenit 136 dhe nenit 138 pika 4 të këtij Kodi.

Neni 115, pika 6, riformulohet si më poshtë vijon:



6. KZAZ-ja mban Procesverbal Konstatimi, në të cilin shënohen të dhënat për kutitë e votimit me fletët e votimit ose kutitë me materialet e votimit të deklaruar të parregullta, sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe të dhëna për pasaktësitë ose parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të procedurave të nenit 116 të këtij Kodi. Kopje të procesverbalit të konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve, subjekteve zgjedhore, si dhe medias.

Neni 115, pika 7, riformulohet si më poshtë vijon:

7. Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së dhe GNV-ve, si dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërim nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim. Originali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim administrohet nga KZAZ-ja, e cila u jep nga një kopje përkatësisht kryetarit, zëvendëskryetarit të KQV-së dhe punonjësit të policisë të caktuar për shoqërimin. Punonjësi i policisë duhet të largohet menjëherë pas marrjes së kopjes së procesverbalit, e cila dorëzohet së bashku me raportin e shërbimit në komandën e strukturës ku ai bën pjesë.

Neni 115, pika 9, riformulohet si më poshtë vijon:

9. Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, të marra në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, vendosen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga KZAZ-ja. Ky vend duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.

Neni 115, pika 10, riformulohet si më poshtë vijon:

10. Kutitë me fletët e votimit të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit, sipas dispozitave të këtij Kodi. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

Neni 26

Numërimi i votave

Neni 116, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:

1. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e numërimit të votave vetëm pasi të gjitha qendrat e votimit të këne mbyllur procesin e votimit nën juridiksionin e saj.

Neni 116, pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

2. Në vijim, anëtarët e Grupit të Numërimit marrin nga sekretari i KZAZ-së modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së, të depozituar në përputhje me pikën 2 të nenit 100 të këtij Kodi.

Neni 116, pika 7, riformulohet si më poshtë vijon:



7. Në rast se nga verifikimet e kryera konstatohen mospërputhje, atëherë Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet në adresë elektronike ose me çdo mjet komunikimi. Njoftimi pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit dhe paleve.

Neni 27

Hapja e kutive të materialeve të votimit

Neni 116/1, pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

2. Në këtë rast Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin. Njoftimi bëhet në adresë elektronike ose me çdo mjet komunikimi. Njoftimi pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit dhe paleve.

Neni 28


Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës

Neni 118, pika 4, riformulohet si më poshtë vijon:

4. Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit për çdo kuti votimi, Grupi i Numërimit rivlerëson fletët e votimit të kontestuara, sipas paragrafit të tretë të pikës 2 të këtij neni. Në rast se edhe pas rivlerësimit ka fletë votimi të kontestuara, numëruesi i parë ose çdo anëtar njofton KZAZ-në për vlerësimin e votave të kontestuara të asaj kutie. KZAZ-ja bën vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje më të. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave.

Neni 118, pika 6, riformulohet si më poshtë vijon:

6. Pas numërimit dhe vlerësimit të votave, sipas këtij neni, për çdo kuti me fletët e votimit, numëruesi i parë numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit. Pas çdo numërimi, shifrën ia bën të ditur anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet nga ndonjë anëtar i Grupit të Numërimit, numëruesi



i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë subjekt. Në rast se pas edhe këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë i Grupit të Numërimit ose anëtari kundërshtues njofton KZAZ-në nëpërmjet komunikimit elektronik. Njoftimi pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit deri në marrjen e vendimit nga KZAZ-ja. KZAZ-ja, pasi të kenë ardhur materialet zgjedhore pranë KZAZ-së, numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron Grupin e Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

Neni 29

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit

Neni 119, pika 5, riformulohet si më poshtë vijon:

5. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të votimit pranë çdo KQV-je. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, përfshirë dhe vendimin për rifillimin e numërimit.

Neni 30

Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave

Neni 121, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:

1. Gjatë procesit të numërimit të votave, në pranë çdo KQV-se, janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KQV-së, anëtarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, si dhe personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, i autorizuar nga KQZ-ja.


Neni 31

Përlllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore

Neni 162, riformulohet si më poshtë vijon:

1. KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike ose koalicionet që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

2. Numri i votave të vlefshme të marra nga secili subjekt zgjedhor pjesëtohet në mënyrë të njëpasnjëshme me numrat tek 1, 3, 5, 7, 9 e në vijim, duke përfutur një seri koeficientësh zgjedhorë. Kur subjekti zgjedhor është kandidat i propozuar nga zgjedhësit, votat e tij pjesëtohen vetëm me pjesëtuesin 1.



3. Të gjithë koeficientët e përftuar sipas pikës 2 të këtij neni renditen në një listë të përbashkët në rend zbritës. Mandatet ndahen në bazë të koeficientëve më të lartë, sipas renditjes në listën e përbashkët, deri në plotësimin e numrit total të mandateve që ndahen në njësinë përkatëse zgjedhore.

4. Nëse ndodh barazimi për shkak se dy ose më shumë koeficientë janë të njëjtë, vendi ndahet me hedhje të shortit nga kryesuesi i KQZ-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike në fjalë. Kjo dispozitë aplikohet vetëm për zgjedhjet për Kuvendin dhe për qeverisjen vendore, për këshillat.

Neni 32

Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore

Neni 166, pika 1 dhe 2, riformulohet si më poshtë vijon:

1. Kryetar bashkie zgjidhet kandidati nëse fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në njësinë vendore përkatëse.

2. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në njësinë vendore përkatëse, KQZ-ja organizon raundin e dytë të zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme. Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet ditën e diele katër (4) javë pas raundit të parë. Kandidati i cili fiton shumicën e votave të vlefshme në raundin e dytë të zgjedhjeve zgjidhet Kryetar në njësinë vendore përkatëse. Në rastet kur dy kandidatë marrin numër të barabartë votash, edhe në raundin e dytë. KQZ-ja organizon raundin e radhes në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrin numër të barabartë votash të vlefshme.

Raundi i radhes i zgjedhjeve mbahet ditën e diele katër (4) javë pas raundit pararendëse. Kandidati i cili fiton shumicën e votave të vlefshme të zgjedhjeve zgjidhet Kryetar në njësinë vendore përkatëse.

Neni 33

Administrimi i zgjedhjeve nga profesionet e rregulluara dhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera të veçanta në Republikën e Shqipërisë.

Neni 168/1, shtohet si më poshtë vijon:

Subjekti Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë detyrohet të zbatojë plotësimin e vendeve pranë çdo komisioni të KQV-ve, GNV-ve dhe KZAZ-ve në gjithë Republikën e Shqipërisë dhe ngarkohet për të zbatuar kërkesat e Kodit Zgjedhor. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë është person juridik, me status të krijuar me ligj të veçantë.”

Subjekti Dhoma e Noterisë së Shqipërisë detyrohet të zbatojë plotësimin e vendeve pranë çdo komisioni të KQV-ve, GNV-ve dhe KZAZ-ve në gjithë Republikën e Shqipërisë dhe ngarkohet për të zbatuar kërkesat e Kodit Zgjedhor. Dhoma e Noterisë së Shqipërisë është person juridik, me status të krijuar me ligj të veçantë.



Subjektet, sipas nenit 5, pikave 1 dhe 2, të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, janë të detyruara t’u nënshtrohen në çdo kohë kërkesave të KQZ-së, për plotësimin e vendeve pranë çdo komisioni të KQV-ve, GNV-ve dhe KZAZ-ve në gjithë Republikën e Shqipërisë sipas procedurave të marrjes, vazhdimit dhe dorëzimit të detyrës, për zbatimin e detyrave të ngarkuara në zbatim të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja është e detyruar të zbatojë nenin 5, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009, Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, për plotësimin e vendeve vakante për anëtarë të KQV-ve, GNV-ve dhe KZAZ-ve, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Neni 34

Prokurimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit

Neni 179, riformulohet si më poshtë vijon:

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë alokon në buxhetin e KQZ-së fondin e nevojshëm për prokurimin, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe implementimin e teknologjisë që do të përdoret në zgjedhje do të kryhen sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik, me një nga procedurat më afatshkurtra që lejon ky ligj për këtë prokurim. Rezultatet që mblidhen nga qendrat e votimit dhe numrimit me metodën e transmetimit të sigurt të rezultateve nëpërmjet tabletëve dhe telefonave celularë (SRT).

3. Ndalohet blerja e sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit për votimin elektronik në zgjedhje, si dhe e pajisjeve që nuk bëjnë identifikimin në kohë reale të zgjedhësve në momentin kur paraqiten në qendrën e votimit.

NËNSHKRUAJNË PROPOZIMET

BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

KRYETARI

Dr. ARIAN STAROVA

NISMA “REFORMA REALE”

KRYETARI

Av. GYLSEN ZHLLIMA



Tiranë, më 18.05.2026.